




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARGALINA Y. DAUTI
ADRESA Rruga "Muhamet Gjollësia,
Pall. Moskat, shk 3, ap 14"
TEL: 692204572



MARRËVESHJE SIGURUESE

Nr. repertori: 447

Nr. koleksioni: 258

Tirane më 02/02/2024

Margalina
Dauti

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten
Margalina Dauti
Data: 2024.02.02
13:35:29+01:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përhëbet nga 2 fletë



A2024050360031532419



MARREVESHJE SIGURUESE

Nr. Date

Ne Tirane, sot me date 02/02/2024 (dy mije e gjate e kaler), para meje Noterit M. Dauti, Noter i Dhomes se Notereve Tirane u paraqiten personalisht:

a. Shoqeria tregtare **VANTO HOME SHPK**, me Seli ne adrese: Tirane Kashar MEZEZ Njësia Administrative Kashar, Kod Unik Pasurie 2679003125, e krijuar e vepron ne baze te ligjeve shqiptare, rregjistruar si person juridik prane QKB date 30/05/2019 rregjistruar ne Organet Tatimore, NUIS Nr L91730010Q , qe ligjerisht perfaqesohet ketu e meposhte nga administratori i saj, **Z. Klodian Sulejmani** lindur me 18.09.1985 vendlindja Durres , banues ne adresen: Lagjia nr 12 Rruga Koco Kaznaxhi Durres me Leternjoftim Numer 034679931 dhe numer personal IS09180570 , madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhet **Barredhenes**);

b. Shoqeria Aksionere "**Banka Credins**" sh.a, me adrese: Rr. "Vaso Pasha", Nr. 8, Tirane, rregjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, me vendimin Nr. 28969, date 31.01.2003, rregjistruar ne organin tatimor me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NUIS Nr. K316088010, si dhe me Licencën e Bankes se Shqiperise Nr.16, date 31.03.2003, perfaqesuar nga **znj Ela Golemi** ne cilesine e Drejtorit te Deges Durres I, lindur me 08.06.1968, me Leternjoftim Nr. 035992095 dhe Nr. Personal G85608057M, dhe **Znj Anxhela Llaftiu**, ne cilesine e analistes se kredie SE, lindur me 08.01.1990, me Leternjoftim Nr.036520211 dhe Nr. Personal J05108066O, madhor/e dhe me zotesi te plote per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhet "**Barremarres**").

Ne kete kontrate, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e domosdoshme nga përmbajtja e nenit. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore dhe anasjelltas.

Neni 1 Objekti i Kontrates

1.1 Krijimi i nje barre siguruese mbi pasuritë e luajtshme te **Barredhenesit**, si garanci per shlyerjen e kredise se akorduar nga Banka Credins ne baze te Kontrates per Kredi nr. /date 20.10.2023 nr. 4934 rep, 27118 kol, date 20.10.2023

1.2 **Barredhenesit** vendosin barre mbi kolateralin e pershkruar si me poshte:

a) **Inventar ne emer te shoqerise Vanto Home shpk ne vleren 276.639.887 Leke**

Neni 2 Baza Ligjore

2.1 Ligji Nr. 8537, dt.18.10.1999 "Per Barret Siguruese" i ndryshuar, Kodi Civil i Republikes se Shqiperise i ndryshuar.

Neni 3 Vlefshmeria

3.1 Marreveshja hyn ne fuqi dite e nenshkrimit nga palet dhe mbetet ne fuqi deri ne shlyerjen e plote te kredise se bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet dhe shpenzimet e tjera te parashikuara, ne kontraten e kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime e saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto.

Neni 4 Garancite

- 4.1 Barredhenesi garanton dhe siguron se eshte pronar legjitim dhe i vetem i kolateralit.
4.2 Barredhenesi garanton Barremarresin se kolaterali eshte ne pronesi te tij, eshte i lire nga cdo barre, detyrim, apo garanci tjetere.

Neni 5 Detyrimet e Barrëdhënësit

- 5.1 Gjatë kohëzgjatjes së kontrates se kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto, per garantimin e te cilave eshte lidhur kjo marreveshje siguroese, Barrëdhënësi është i detyruar te ruaje, mirëmbaje, siguroje dhe te mos lejoje perkeqesimin e situates ligjore dhe financiare te kolateralit te bllokuar ne favor te Barremarresit ne perputhje me kete marreveshje siguroese.
5.2 Barrëdhënësi do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo fakt dhe rrethanë që mund të rrezikojë/perkeqesoje situaten ligjore dhe financiare te kolateralit dhe ose ekzekutimin e tij.
5.3 Barredhenesi ka detyrimin per te njoftuar Banken per cdo konflikt gjyqesor dhe/ose administrativ ne lidhje me kolateralin objekt i kesaj marreveshje siguroese.

Neni 6 Kompletimi i barres siguroese

- 6.1 Barra siguroese quhet e kompletuar me permbushjen e sa specifikuar ne Ligjin "Per barret siguroese" i ndryshuar.
6.2 Barredhenesit me/ane te kesaj marreveshje autorizojne Barremarresin te nenshkruaje, kompletoje, regjistroje dhe depozitroje te gjitha dokumentet e nevojshme ne te gjitha regjistrat perkates te percaktuar nga ligji ku pasqyrohet bllokimi i kolateralit me qellim Kompletimin e Barres Siguroese.
6.3 Barredhenesit do te paguajne shpenzimet per kompletimin, regjistrimin, depozitim etj e te gjitha dokumenteve te nevojshme ne te gjitha regjistrat perkates te percaktuar nga ligji per efekt te bllokimit te kolateralit me qellim Kompletimin e Barres Siguroese.

Neni 7 Detyrimet e siguruara

- 7.1 Barredhenesit sigurojne me kolateralin:
- i. Pagimin e detyrimit sipas kontrates se kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto;
 - ii. Kryerjen e te gjitha veprimeve ligjore qe burojne nga aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojne keto marredhenie;
 - iii. Pagimin e shpenzimeve per ekzekutimin e kolateralit.

Neni 8 Ekzekutimi i barres siguroese

8.1 Ne rastin kur Kredimarresi eshte ne vonese ne pagimin e kesteve mujore se bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet, te parashikuara ne kontraten e kredise te specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto, Bankes i lind e drejta per te deklaruar si te kerkueshme per tu paguar te gjitha detyrimet e garantuara me Marreveshjen Siguroese, si dhe shpenzimet qe perfshijne shpenzimet gjyqesore si dhe cdo shpenzim





A1024050360031532419

ligjor deri ne ekzekutimin e plote te tyre, sipas procedurave te parashikuara ne Ligji Nr. 8537, dt.18.10.1999 "Per Barret Siguruese" i ndryshuar.

8.2 Barrëdhënësi, menjëherë pas marrjes së njoftimit nga Banka, do të dorëzojë kolateralin me shpenzimet dhe në përgjegjësinë e tij në çdo vend të përcaktuar nga Banka, bashkë me dokumentet përkatëse. Në rast se Barrëdhënësi nuk e përmbush këtë detyrim, Banka do të vijoj me procedurën e ekzekutimit të parashikuar ne Ligjin "Per Barret Siguruese" i ndryshuar.

Neni 9

Verifikimi i kolateralit

9.1 Barremarresi ose agjentet e tij kane te drejte te bejne inspektime dhe te verifikojne kolateralin ne cdo kohe dhe kohe pas kohe, dhe Barredhenesi eshte dakort qe te ofroje gjithë asistencen dhe informacionin e duhur mbi gjendjen ekzistuese apo kushtet dhe rrethanat qe ndikojne mbi te.

Neni 10

Ndalime qe kufizojne te drejtat qe lindin nga pronesia

10.1 Barredhenesi nuk ka te drejte te ndryshoje apo te krijojte te drejta pronesie ose te drejta te tjera reale mbi kolateralin, ta perdore ate si kolateral per detyrime te tjera te tashme apo te ardhme, te tyre apo te te treteve pa marre me pare pelqimin me shkrim te Barremarresit.

10.2 Barrëdhënësi nuk ka të drejte të transferojë, të tjetersojë apo disponoje, ne cfaredo forme, kolateralin e barrësuar apo të zvogëlojë vlerën e tij pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

Neni 11

Vazhdimesia e sigurimit te ekzekutimit te detyrimit

11.1 Ne rast se kolaterali humbet, demtohet apo zhvleftehet, si dhe kur Banka çmon se vlera e tij nuk mjafton apo eshte zvogeluar ne vlere, për të mbuluar detyrimin e siguruar nga kolaterali barremarresi ka te drejte te kerkoje shtimin e kolateralit si dhe garanci te plote nga pasuri te tjera te barredhenesit, ndersa Barredhenesi ka detyrimin ta shtojte kolateralin me kerkesen me te pare te Barremarresit.

11.2 Kjo marreveshje siguruese është titull ekzekutiv.

Neni 12

Mosmarreveshjet

12.1 Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis paleve si rezultat i kesaj marreveshje siguruese zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 13

Ndryshimet

13.1 Shtesa, ndryshime nga kjo Marreveshje duhet te behen me shkrim dhe te nenshkruhen nga palet.

13.2 Kjo Marreveshje se bashku me shtesat apo ndryshimet e saj do te jene detyruese per barredhensit dhe trashegimtarët e tyre respektiv.

Neni 14

Njoftimi Zyrtar midis Paleve

14.1 Te gjitha njoftimet dhe komunikimet midis paleve ne kete marreveshje, do te behen me shkrim te dorezuara personalisht ose me poste te regjistruar (rekomande) dhe/ose adresen e e-mail ne adresen e percaktuar ne kete marreveshje.



A2024050360031532419

14.2 Barredhësit deklarojnë dhe pranojnë që të gjitha llojet e njoftimeve të bëra në adresat e deklaruara nga ana e tyre sipas kësaj marrëveshje do të konsiderohen si të marra nga ai/ata.

14.3 Barredhësit janë të detyruar që të njoftojnë menjëherë çdo ndryshim në adresën e tyre. Për sa kohë që ata nuk kanë njoftuar adresën e re, njoftimet do të quhen si të kryera dhe barredhësit nuk kanë të drejtë dhe heqin dorë nga çdo pretendim në lidhje me njoftimet e bëra në adresën e dekluarur prej tyre sipas kësaj marrëveshje.

Kjo Marrëveshje Siguruese hartohet në 5 (pese) kopje me vlerë të barabartë, dhe pasi lexohet dhe gjendet konform vullnetit të lirë e të plotë të paleve nënshkruhet si më poshtë. Une noteri e vertetoj atë sipas ligjit.

PALET KONTRAKTUESE

BARREMARRES

BANKA "CREDINS" Sh.a.

Drejtor Dege Durrës 1

Znj. Ela Golemi

Analiste Kreditë SE

Znj. Anxhela Llaftiu

BARREDHËNES


Shoqëria tregtare "VANTO HOME" SHPK

Perfaqësuar nga

Z. Klodian Sulejmani

MD
NOTER

Margalena Dauti (Karteri)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARGALINA Y. DAUTI
ADRESA Rruga "Muhamet Gjollësia,
Pall. Moskat, shk 3, ap 14"
TEL: 692204572


KONTRATË KREDIE

(KONTRATË KREDI BANKARE)

Nr. repertori: 4934

Nr. koleksioni: 2748

Tirane më 20/10/2023



Margalina
Dauti

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikatën
:Margalina Dauti
Data: 2023.10.20
11:12:25+02:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar

Tutti material përmbledhet nga 11 fletë



A2023050360314057674

KONTRATE KREDIE

Nr. 2374 / Date 20.10.2023



Sot, djeft te premte me date 20.10.2023 para meje H. Dauti, noter ne Degen Vendore Njome, me adrese ne Rr. Muhamet Gjaleci paraqiten personalisht per te redaktuar kete kontrate palet.

KREDIDHENES: Shoqeria Aksionere "Banka Credins" sh.a, me adrese: Rr. "Vaso Pasha", Nr. 8, Tirahe, regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, me vendimin Nr. 28969, date 31.01.2003, regjistruar ne organin talimor me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NUIS Nr. K316088010, si dhe me Licencën e Bankes së Shqiperise Nr.16, date 31.03.2003, perfaqesuar nga Znj. Elona Faik Barxhani ne cilesine e Drejtorit Dega Durres 2, lindur me 13.11.1982, banues ne Durres, mbajtes i Leternjoftimit Nr 037024465, Nr Personal I261130900, dhe Znj Anxhela Llaftiu, ne cilesine e analistes se kredie SE, lindur me 08.01.1990, me Leternjoftim Nr.036520211 dhe Nr. Personal J051080660, madhor/e dhe me zotesi te plote per te vepruar dhe,

KREDIMARRRES DHE BARREDHENES: Shoqeria tregtare "VANTO HOME" SHPK, me Seli ne adrese: Tirane Kashar MEZIEZ Njesia Administrative Kashar, Kod Unik Pasurie 2679003125, e krijuar e vepron ne baze te ligjeve shqiptare, regjistruar si person juridik prane QKB date 30/05/2019 regjistruar ne Organet Tatimore, NUIS Nr L91730010Q qe ligjerisht perfaqesohet ketu e meposhte nga Administratori i saj, Z. Klodian Sulejmani lindur me 18.09.1985 vendlindja Durres, banues ne adresen: Lagjia nr 12 Rruga Koco Kaznaxhi Durres me Leternjoftim Numer 034679931 dhe numer personal I509180570, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe;

DOREZANES DHE BARREDHENES: Z. Klodian Sulejmani lindur me 18.09.1985 vendlindja Durres, banues ne adresen: Lagjia nr 12 Rruga Koco Kaznaxhi Durres me Leternjoftim Numer 034679931 dhe numer personal I509180570, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe

DOREZANES DHE BARREDHENES: Shoqeria tregtare "EUROMOBILJE" SHPK, me Seli ne adrese: Tirane Njesia Bashkiake nr.6, Rruga Sabaudin Gabrani, godine I kateshe me ne pasurie 5/286, zona kadastrale 8240, e krijuar e vepron ne baze te ligjeve shqiptare, regjistruar si person juridik prane QKB date 09/02/1998 regjistruar ne Organet Tatimore, NUIS Nr J81512001K qe ligjerisht perfaqesohet ketu e meposhte nga administratori i saj, Z. Alfred Mezini lindur me 27.07.1968 vendlindja Tirane, banues ne adresen: Tirane Rruga Themistokli Gërmenji me Leternjoftim Numer 033986909 dhe numer personal G80727108K, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Palet ne kete kontrate kane rene dakord per perpilimin dhe nenshkrimin e kesaj kontrate me termat dhe afatet e meposhtme:

N e n i 1

Baza Ligjore dhe Statusi Juridik

- 1.1 Kjo kontrate hartohet bazuar ne nenet 6,24,31,419 e vijues, 585,1031 e ne vazhdim te Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 110, date 20.12.2018 "Per Noterine".
- 1.2 Palet kane rene paraprakisht dakort qe te lidhin kete kontrate Kredie, me kushtet e meposhtme.
- 1.3 Kredimarresi nuk mund t'ia transferoje te treteve kete kredi dhe te drejtat e lidhura me te, pa matre miratimin me shkrim te bankes.
- 1.4 Kredimarresi pranon zbatimin e kesaj kontrate ne kushtet e permendura dhe mundesine e perdorimit nga ana e Bankes e te gjithe autoritetit dhe te drejtes se lindur nga nenshkrimi i kesaj kontrate

N e n i 2

Objekti i Kredise

- 2.1 Banka bie dakort qe t'i jape Kredimarrësit nje kredi ne shumen 150.000 (Njeqind e pesedhjetë mijë) Euro me qellim: Kapital Qarkullues, sipas afateve dhe kushteve te parashikuara ne kete kontrate.
- 2.2 Kredia ne fjale do te perdoret vetem per qellimin e permendur me siper, dhe Kredimarrësi ka rene dakort te paguaj shumen e kredise dhe interesin mbi te si dhe ta siguroje Banken me garanci pa asnje rezerve, sipas percaktimeve te kesaj kontrate.

- 2.3 Ne rastin e konstatimit apo te te dhenave se kredimarresi po e perdor kredin e marrë nga Banka për qëllime të cilin është miratuar dhe levruar kjo kredi, Bankes i lind e drejta që në anënyrë të kontratave të kerkoje ose zgjidhjen e kontrates dhe kthimin mbrapsht te vleres se kredise ne total se bashku me penalitetet, interesat e akumuluar deri ne momentin e kerkimit nga Banka ne rastet kur ky devijim demton interesat dhe imazhin e Bankes, ose te aplikojte nje penalitet ne masen 2% mbi shumen fillestare te kredise.
- 2.4 Banka nuk do te lejoje disbursimin e kredise dhe/ose perdorimin e kredise nese Kredimarresi nuk permbush kushtet e meposhtme:
- I gjithë dokumentacioni i kerkuar është plotësuar nga Kredimarresi ne forme të drejtë ne permbajtje sipas kerkesave te Bankes.
 - Te gjitha veprimet, faktet juridike, vertetimet, deklaratat, pohimet ne lidhje me kontratën, te bera nga Kredimarresi per Banken jane te verteta dhe korrekte ne daten e kerkimit. Kredimarresi është dakort se çdo moskorrektesi apo pasaktesi ne dokumentacion nga ana e tij, te cilat kane pasur si qellim tjetërsimin e situates ligjore apo financiare te klientit ne funksion te perfitimit te kredise do te shkaktoje aplikimin e penaliteve ne masen 2% te vleres outstanding te kredise dhe/ose zgjidhjen e kontrates.

Neni 3

Kohëzgjatja dhe Çelja e Kredise

- 3.1 Banka do t'i akordojë Kredimarrësit shumën e kredise, duke respektuar ligjet dhe rregullat e autoriteteve monetare.
- 3.2 Kredia akordohet për një afat 36 (Tridhjetë e gjashtë) muaj për financimin e kredimarrësit sipas objektivit të kësaj kontrate kredie. Afatet do të fillojnë nga dita e disbursimit.
- 3.3 Si kusht për levrimin e kredise, Kredimarrësi do të hapë një ose më shumë llogari rrjedhese pranë "Banka Credins" sh.a, në të cilën Banka do të bëjë disbursimin e fondeve dhe nepermjet se ciles do të behet ripagimi i kredise.
- 3.4 Kredimarrësi do të kanalizojë pranë Bankes Credins të gjitha transaksionet financiare që lindin me kredine ne fjale si dhe transaksione te tjera ne peshe te barabarte me peshen qe financimi i Bankes Credins do te perbeje ne totalin e ekspozimeve bankare te klientit. Volumi i transaksioneve financiare te cilat do te kanalizohen pranë Bankes Credins do te jete 20% e totalit te volumit te transaksioneve financiare te klientit
- 3.5 Disbursimi i kredise ne shumen prej 150.000 (Njeqind e pesedhjetë mijë) Euro do te behet pas nenshkimit te Kontratave, pas aplikimit te pengjeve ne RBS, para bllokimit te pengjeve ne QKB dhe RBS si dhe para administrimit te policave se sigurimit te jetes dhe sigurimit te pengjeve.
- 3.6 Si moment i regjistrimit do të shërbejë tërheqja nga ASHK perkatëse e vertetimit zyrtar për hipotekimin e pronave të percaktuara ne kontratën e hipotekes nr. _____ rep., nr. _____ kol., date _____, ne favor te "BANKA CREDINS" SH.A.
- 3.7 Si moment i regjistrimit të marrëveshjes siguroese do të shërbejë tërheqja nga Regjistri i Barreve Siguroese i vertetimit zyrtar për bllokimin e pasurive të percaktuara ne Marrëveshjen Siguroese nr. _____ rep., nr. _____ kol., date _____, ne favor te "BANKA CREDINS" SH.A.
- 3.8 Banka rezervon te drejten për te mos e levruar kredine dhe pas hipotekimit te kolateralit ne favor te BANKES CREDINS nese ka nje informacion, i cili riskon kredine.
- 3.9 Perdorimi i kredise, do të behet me kerkese te thjeshte te Kredimarrësit, keshtu qe çdo fallsifikim, ndryshim, veprim i kunderligjshem apo abuzim ne menyrtat e terheqjes, çdo perdorim ligjor ose jo i numrit te kodit personal te llogarise se tij, si edhe shperdorimet nga organet dhe perfaqesuesit e tij, rendojne mbi Kredimarrësin dhe për rrjedhojë çdo pagese e bere nga Banka ne kushtet e mesiperme por pa u kufizuar vetem ne keto, konsiderohet e ligjshme dhe perben detyrim për Kredimarrësin sikurse edhe çdo transaksion qe bazohet ne tërheqjen elektronike, ne çeqe, ne urdhra te cilat jane te falsifikuar.
- 3.10 Kur gjatë disbursimit Banka konstaton se Kredimarrësi ka dale jashte kushteve te parashikuara ne kete kontrate, Banka ka te drejte te kerkoje zgjidhjen e kesaj kontrate qe do te shoqerohet me kthimin e shumave te perdorura deri ne ate moment dhe interesin perkates.

Neni 4

Llogaria e Klientit

- 4.1 Kredia do të levrohet në llogarinë rrjedhese të Kredimarrësit. Kredimarrësi në menyre te përvokueshme dhe te pakushtezuar, autorizon Bankën te debitoje automatikisht llogarinë e tij për secilin dhe të gjitha detyrimet ndaj Bankes, për kryerjen e veprimeve dhe të shpenzimeve ndaj

paleve te treta te lidhura me kredine. Keto shpenzime perfshijne shpenzime ne lidhje me vleresimin dhe rivleresimin e kolateralit, shpenzime ne lidhje me barresimin ushteseve te luajtshme dhe / ose te paluajtshme, sherbime ligjore si dhe cdo shpenzim qe rrjedh si rezultat dhe / ose ne fidhje me kredine.

- 4.2 Shpenzimet e hapjes dhe te mirembajtjes se nje llogarie ose mjete tjeter pagese per transakcionet e levrimet te kredise dhe pageses, si dhe kosto te tjera lidhur me transakcionet e pagesave ne pergjithesi, do te perfshihen ne koston totale te kredise per klientin.
- 4.3 Palat kane rene dakord qe gjendjet e llogarise te cilat tregojne transakcionet e kryera per llogari te Kredimarresit, perbejne prove te plote per te mbeshtetur pretendimet e Bankes ndaj Kredimarresit
- 4.4 Banka ka te drejte te mbaje nje apo me shume llogari ne varesi te monedhies ne te cilen perdoret kredia, perfshire edhe terheqjen ne leke dhe ne valute, kur kjo eshte e domosdoshme. Llogarite e mesiperme, ashtu si edhe llogarite e kredise mund te mbylten ne menyre te pavarur nga tjera-tjetra.

Ne ni 5 Interesi dhe periudha e interesit

- 5.1 Norma e interesit te kredise eshte percakuar ne piken 5.2 te kesaj kontrate dhe kredimarresi duke qene subjekt i dispozitave te kesaj kontrate, duhet te paguaje interesin qe rrjedh nga kredia ne ditën e fundit te çdo periudhe interesit.
- 5.2 Norma e interesit e aplikuar per kredine do te jete Euribor 12 mujore + 5.5 % (pese pike pese perqind) me baze vjetore dhe per llogaritja e saj do te filloje ne ditën e disbursimit te kredise, dhe mbarojë nje dite pune me vone nga ripagimi i kredise. Norma e interesit do te jete e shprehur si shuma e nje norme indeks X% (Euribor), qe eshte pjesa e ndryshueshme ne varesi te normave ne treg, dhe nje spread 5.5 % (pese pike pese perqind) qe eshte pjesa e pandryshueshme e normes.
- 5.3 Norma e interesit te aplikuar nuk mund te bjere me poshte se 7.5 % (shitate pike pese perqind).
- 5.4 Banka cdo date 1 te tremujorit kalendarik (nese data 1 do te jete pushim zyrtar, ditën e pare te punes se fillim tremujorit kalendarik) realizon ndryshime te normes indeks (Euribor 12 mujor) te normes se interesit ne vartesi te ndryshimit te kushteve te tregut kombetar/ndekombetar (Euribor 12 mujor).
- 5.5 Normat e interesit te Bonove te Thesarit te emetuara nga qeveria shqiptare raportohen ne REUTERS ne faqen AL/TSYRESULT01 ose ne buletin zyrtar dhe njollimet perkatese te Bankes se Shqiperise. Norma e interesit EURIBOR publikohet ne REUTERS ne faqen EURIBOR. Normat e interesit CmeTermSofr Usd publikohen ne REUTERS.
- 5.6 Banka me pelqimin me shkrim te Kredimarresit ka te drejte te ndryshoje Spread-in (pjesa e pandryshueshme) e normes se interesit te kredise ne varesi te ndryshimeve te kushteve te tregut (ndryshime te theksuara te normave te interesit ne treg, normes se inflacionit, kurseve te kembimit, kostove te bankes, et
- 5.7 Ne rastin e rritjes se normes indeks ne treg, mbi 5% nga norma fillestare e interesit sipas kushteve te kontrates, Kredimarresi mund te beje kerkese prane bankes per rishikimin e kushteve te kontrates se kredise ne lidhje me normes e interesit.
- 5.8 Kredimarresi eshte ne dijeni dhe pranon faktin se shuma ekuivalente e kesit mujor te principalit dhe interesit per tu paguar mund te rritet ose zvogelohet ne varesi te ndryshimit te normes se interesit (Euribor). Kredimarresi eshte plotesisht ne dijeni dhe pranon faktin qe shuma ekuivalente ne lek e kesit mujor te principalit dhe interesit per tu paguar mund te rritet ose zvogelohet ne varesi te ndryshimit te kursit te kembimit.
- 5.9 Norma e interesit efektiv (NEI) ne momentin e akordimit te kredise do te jete 8.54% me baze vjetore. Norma e interesit efektiv ndryshon ne varesi te interesit nominal cdo fund tremujori kalendarik.
- 5.10 Nese ne kete kontrate jane te parashikuara dispozita, qe lejojne ndryshime ne normat e interesit ose shpenzimet e tjera qe perfshihen ne normen efektive te interesit, por te pamatshme ne kohe kur kjo norme llogaritet, norma efektive e interesit llogaritet duke supozuar qe perqindja e interesit dhe shpenzimet e tjera te mbeten te pandryshuara (fikse), ne lidhje me nivelin e percaktuar ne datën e nenshkrimit te kesaj kontrate.
- 5.11 Banka, siguron kredimarresit, sipas formes se percaktuar ne kete kontrate, te pakten nje here ne 12 muaj, informacionin e meposhtem:
- a. normen vjetore te interesit ne fillim dhe ne fund te periudhes perkatese;

b. pjesen e papaguar te kredise ne fillim dhe ne fund te periudhes
c. shumen e cdo kesti kredie, te percaktuar sipas nje plani pagesash dhe koston e kësaj te paguhet cdo kest, bazuar ne normen vjetore te interesit, te aplikuar ne fund te periudhes perkatese.

Neni 5/1

Klauzola e ndryshimit të indeksit orientues

- 5/1.1 Kredimarrësi njeh dhe pranon të drejtën e bankës për të zëvendësuar indeksin orientues, në rast të aplikimit të interesit të përbërë, nëse ndodh një ndërprerje nga ana institucioneve përkatëse të kuotimit/publikimit të këtij indeksi orientues për monedhën e kredisë. Indeksi orientues ekzistues do të zëvendësohet me indeksin orientues të ri të njoftuar/shpalluar nga institucionet kompetente, sipas rastit.
- 5/1.2 Kjo dispozitë aplikohet vetëm në rast se ka një përcaktim të qartë të datës së ndërprerjes së kuotimit të indeksit orientues për monedhën dhe zëvendësimin e tij me një indeks orientues alternativ të publikuar nga autoritetet rregullatore. Banka njofton klientin paraprakisht për datën e ndërprerjes së aplikimit të indeksit orientues ekzistues dhe aplikimit të indeksit orientues të ri

Neni 6

Komisionet

- 6.1 Kredimarrësi do të paguajë një komision disbursimi prej 1 %(një përqind) te kredise, i pagueshëm ditën e disbursimit te pare. Kredimarrësi autorizon Banken që te mbaje paraprakisht nga shuma e kredituar, komisionin e disbursimit.
- 6.2 Në rastin kur konstatohet se pas 1 (një) muaji nga disbursimi i kredise ka pjese te paperdorura te kredise, kredimarrësi do të paguaj një komision prej 2 (dy) % mbi baze vjetore, e perllogaritur mbi masen e-paperdorur te kredise deri ne perfundim te kesaj periudhe.
- 6.3 Në rast te mospagimit te komisioneve, Banka ka te drejte te aplikojë një penalitet prej 4 (kater)% ne muaj mbi shumen e papaguar te komisionit dhe interesit.

Neni 7

Ripagimi i kredise

- 7.1 Paguesat e kesleve do te behen siç eshte parashikuar ne planpagesen bashkelidhur kesaj kontrate.
- 7.2 Kesti i kredisë, per kredinë me keste fikse, përllogaritet sipas metodës më poshtë:
$$P = (Pv * R) / [1 - (1 + R)^{-n}]$$

Ku:
P = Monthly Payment – Kesti mujor
Pv = Present Value – Shuma e Kredise
APR = Annual Percentage Rate – Norma vjetore e kredise
R = Periodic Interest Rate = APR/number of interest periods per year – Norma/numrin e periudhave ne vit pra nese kestet jane mujore e pjesetojme ne 12
n = Total number of interest periods (interest periods per year * number of years) – numri total i kesleve.
- 7.3 Kredimarrësi do te ripaguaje ne favor te Bankes huan, per hlogari te principalit, interesit, kostove, shpenzimeve dhe kostove te tjera, te lira dhe te pazbritshme nga ndonje tatim, detyrim, takse e tashme apo e ardhshme, apo edhe detyrime te tjera.
- 7.4 Paguesa e pare e kesit te kredise (principal +interes) do te behet pas 1(nje) muaji nga momenti i disbursimit te pare te kredise, dhe me pas do te behet cdo muaj. Në qofte se data e pageses se kesit te kredise do te hjere ne nje dite, e cila nuk eshte dite pune, atehere pagesa e kesit te kredise mund te mbyllet ne ditën e punes se mepasme.
- 7.5 Në rast se kredimarrësi nuk paguan në kohë kështin e matuar ose principalin, Banka përveç normës së interesit normal, ka të drejtë të aplikojë penalitet në masën përqindje bazë plus + 5% në vit në rast se monedha e kredisë është në lekë dhe plus +3% në vit në rast se monedha e kredisë është në valutë, i hlogaritur mbi detyrimin e kesit të papaguar (principal+interes), për periudhën në të cilën ai është në vonesë në bazë të kushteve të kësaj kontrate.
Perllogaritja e penalitetit behet:
Shuma ne vonese X normen e penalitetit % X 12 muaj / 360 dite X ditet ne vonese.

- 7.6 Me ane te kesaj kontrate Kredimarrësi dhe/ose Dorezanesi bie përkrahje dhe garancie për kryerjen e detyrimeve të krijuara nga marrëveshja e kreditit. Paraparakishtë Bankën në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar që të marrëveshjet të krijuara të llogaritet rjedhese të tij/tyre, në rast se kredimarrësi është në vonese në pagimin e kësaj kontrate të radhes.
- 7.7 Kredimarrësi ka të drejtën për t'u tërhequr nga marrëveshja e kreditit brenda një periudhe kalendarike 14 ditore, pa detyrim justifikimi duke paguar detyrimet deri në momentin e parapagimit (vetëm principal dhe interesin për ditët përkatëse).
- 7.8 Përpara ushtrimit të kësaj të drejte kredimarrësi njofton bankën për synimin e tij (brenda afatit prej 14 ditësh) për t'u tërhequr nga marrëveshja e kreditit.
- 7.9 Banka njofton klientin për vlerën e kreditit dhe interesin për t'u kthyer për ditët përkatëse. Interesi llogaritet mbi bazën e normës së interesit të rënë dakord dhe nuk do të paguhet asnjë penaltitet tjetër për ushtrimin e kësaj të drejte.
- 7.10 Kredimarrësi ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, edhe para afatit të maturimit, shlyerje të pjesëshme ose të plote të detyrimeve të tij të lindura nga kontrata e kreditit.
- a) Për kreditë për investime dhe/ose kapital qarkullues, penaltiteti do të jetë 5% (pesë përqind) e shumës së kreditit së paguar përpara afatit në rast se kredia do të mbyllet me fondet e siguruar nga financimi në bankë (jetër dhe 3% (tre përqind) nëse mbyllet me fondet e klientit.
- 7.11 Për kthimin para kohe të shumës së kreditit sipas pikave a), b) të nenit 7, pika 9, kredimarrësi është i detyruar të njoftojë Bankën me shkrim në mënyrë të përvokueshme të paktën 10 ditë përpara afatit të mbylljes së huasë. Perlllogaritja e penaltitetit bëhet: Shuma që parapaguhet X normën e penaltitetit %.

Neni 8

Garantimi i kredise

- 8.1 Kredimarrësi kundrejt kredise dhene nga Banka, e siguron kete te fundit me ane te garancise, perfaqesuar nga Marrëveshja Siguruese Date si edhe dorezania e subjekteve te perfshira me statusin e dorezanesve ne kete kontrate kredie.
- 8.2 Kredimarrësi dhe/ose Dorezanesit, në mënyrë të sigurojnë pëmbashjen e kushteve dhe afateve të kesaj kontrate kredie si dhe ripagimin e huasë, së bashku me interesin, penaltitetet, komisionet, shpenzimet, detyrimet etj, do të vendosin si garanci :
- a) Inventar në emer të shoqërisë Vanto Home shpk në vlerën 276.639.887 Leke
- b) 100% të kuotave dhe të drejtat që lidhen me to që z. Klodian Sulejmani dhe Shoqëria tregtare EUROMOBILJE SHPK zoterojnë në shoqërinë tregtare VANTO HOME SHPK, me NUIS L91730010Q, me seli në Tiranë Kashar MEZEZ Njësinë Administrative Kashar, si edhe mbi knotat/aksionet e reja që mund të zoterojë në të ardhmen në kete shoqëri tregtare.
- 8.3 Kredimarrësi dhe/ose Dorezanesit nuk do të krijojnë ndonjë hipoteke, peng, kompesim, garancie, servitut, uzufrukt, barre siguruese, apo edhe çdo kufizim tjetër mbi kete pasuri pa miratimin paraprak të Bankes. Kredimarrësi dhe/ose Dorezanesit nuk do të kryejnë pa miratimin paraprak të Bankes veprime për kalimin e pronësise, pjestim pronësie, dhurim, shitje etj, në pronën mbi të cilën është krijuar hipoteka, por edhe çdo pasuri që mund të lidhet me kete pasuri në mënyrë të pazgjdhshme gjatë kohezgjatjes së kontrates së kreditit, përse kohe nuk ka shlyer plotësisht kredine, interesin përkatës, komisionet, penaltitetet dhe shpenzimet e tjera të lidhura me kete kredi. Çdo veprim në kundërshtim me kete nen do të bëjë kthyeshme kredine bashkë me shpenzimet e tjera, plus interesat, penaltitetet, demet, dhe kamatat dhe çdo shpenzim tjetër.
- 8.4 Kundrejt kredise së dhene nga Banka, Kredimarrësi dhe/ose Dorezanesit e garantojnë kete te fundit, duke marrë persiper ripagimin e kreditit me çdo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të tyre të tashme dhe të ardhme dhe pa u kushtëzuar vetëm në keto.
- 8.5 Palet kanë rënë dakort se hipoteka e krijuar sipas kesaj Kontrate kredie bankare, është e vlefshme dhe në fuqi, si dhe do të shërbejë si kolateral edhe për çdo shtese apo ndryshim kontrate, rinovim linje/kredie, ristrukturim, pa patur nevojë për t'u reregjistruar dhe/ose konfirmuar në çdo rinovim, apo për të bërë riblokim të pasurive të vena si kolateral me kontratën e hipotekes, kjo në referencë të nenit 509 të K.Civil, me kusht që vlera e kesaj hipoteke të jete në përputhje me vlerat e kerkuara nga Banka për raportin Kolateral/Kredi.
- 8.6 Banka, në rast të mospëmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontrate nga ana e Kredimarrësit, ka të drejtë të sekuestronjë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, llogarite e bllokuara dhe sendet e tjera me vlerë.

- 8.7 Kontrata e Hipotekes dhe/ose marreveshja siguruese janë/është pjesë e Kredie.
- 8.8 Dorezanesit, garantojnë pa kushte Banken Kredidhënëse se do të përgjigjen me të gjithë pasurinë e tyre, për përmbushjen e detyrimeve në total që rrjedhin nga kjo kontratë kredie, në rast se Kredimarrësi nuk përmbush detyrimin e tij, duke përfshirë edhe pagimin e kamates, penaltitet, shpërblimin e demit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit dhe shpenzimet e tjera administrative, noteriale, gjyqesore dhe përbarimore që ka bërë banka .
- 8.9 Dorezanesit, janë të detyruar solidarisht dhe njëkohësisht me Kredimarrësin (debitor kryesor) pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme për ekzekutimin e detyrimit. Pa dijeninë e bankes, Dorezanesit nuk do të kryejnë asnjë veprim që do të shkaktojë pakesimin e sasise apo vleres së pasurisë së tyre.
- 8.10 Me kërkesën e parë të Bankes, Dorezanesi i njëjti asaj të drejtën për të pretenduar veprim dhe përfituar drejtëpersdrejtë mbi pasurinë e luajteshme dhe të paluajteshme të tij.
- 8.11 Çdo gjë tjetër në marrëdhëniet mes Bankes, kredimarrësit dhe dorezanesit të tij, e pa përmendur këto marreveshje, do të zgjidhet sipas dispozitave të nenëve 585 deri 600 të Kodit Civil.
- 8.12 Banka, në rast se garancite e dhëna nga kredimarrësi, për shkak të ndryshime, nuk e mbulojnë kredinë e dhënë plus interesat, kërkon vendosjen e garancive shtese. Në rast refuzimi nga ana e Kredimarrësit për të përmbushur detyrimin e mesipër, Banka ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës së kredisë dhe/ose kthimin e menjëhershëm të saj.
- 8.13 Kredimarrësi është i detyruar të marrë të gjitha masat dhe të kryejë çdo shpenzim të kërkuar për të ruajtur vlerën e garancisë. I njëjti detyrim ekziston edhe kur Banka dhe kredimarrësi janë në konflikt gjyqësor, për sa kohë që sendi nuk ka kaluar plotësisht në posedim të Bankes.

N e n i 9 Detyrimet e Kredimarrësit

- 9.1 Për sa kohë nuk ka shlyer detyrimin monetar apo detyrime të tjera të kërkuara nga Banka, Kredimarrësi duhet:
- Te japë sa here që i kërkohej nga Banka, çdo dokument ose të dhënë që provon respektimin e kushteve ligjore dhe të kushteve të kësaj kontrate.
 - Te paguajë kredinë rregullisht kredinë deri në shlyerjen e plotë të saj duke përfshirë shumë të terhequr pa miratim si dhe të gjitha interesat dhe penaltitet e percaktuara në këtë kontratë. Interesat do të llogariten deri në ekzekutimin perfundimtar të detyrimit të kredisë së bashku të gjitha interesat dhe penaltitet e mbledhura deri në momentin e ekzekutimit perfundimtar.
 - Te ushtroje aktivitetin në përputhje me praktikën e mira të biznesit sipas ligjeve dhe akteve të tjera nenligjore duke mirëmbajtur dhe mirëadministruar mjetet kryesore, pasuritë dhe çdo mjet tjetër material ose financiar në pronësi të tij dhe vecanërisht të beje shpenzimet e nevojshme për ruajtjen e vlerës së kolateralit.
 - Te mbajë në çdo kohë dhe në mënyrën e duhur të gjitha librat, regjistrimet ose të dhënat financiare për evidentimin e aktivitetit tregtar duke lejuar Banken ose përfaqësuesit e saj të ujinë me këto të dhëna dhe të vizitojë dhe/ose inspektojë të gjitha mjediset ku ai ushtron aktivitetin e tij.
 - dh. Te lejojë Banken, kur ajo e shikon të arsyeshme: a) të kryej Inspektimin dhe vlerësimin e mjedisit ku zhvillohet aktiviteti. Në këtë rast të gjitha shpenzimet do të përballohen nga Kredimarrësi.
 - e. Për kliente me total ekspozim/oustanding mbi 5.000.000 ALL deri në 20.000.000 ALL (njzet milion leke) ose ekuivalenti në monedhe të huaj, të lejojë përfaqësuesin/punonjësën e bankes, të kryej verifikimin fizik/monitorimin të kolateralit sa herë që do të kërkohej nga Banka (jo më shumë se 1 herë në vit).
- Për kliente me total ekspozim/oustanding mbi 20.000.000 ALL rivlerësimi i kolateralit, do të kryhet nga eksperti vlerësues, i zgjedhur nga Kredimarrësi, sipas listës të miratuar nga banka për vlerësimet e kolateraleve, çdo 2 (dy) vjet nga dita e disbursimit apo nga dita e vlerësimit me të fundit. Përfundimisht kur banka e shikon të arsyeshme, verifikimi fizik/monitorimi dhe/ose vlerësimi i kolateralit pasuri e paluajteshme dhe/ose luajteshme do të kryhet edhe përpara perfundimit të afatit 2 (dy) vjeçar. Do të realizohet rivlerësimi 1 herë në vit në rastet kur:
- Ekspozimi garantohej nga pasuri e paluajteshme komerciale
 - Ekspozimi garantohej nga pengjet plotësisht ose pjesërisht
 - Kredimarrësi shfaq probleme me shlyerjen e kredisë apo ka vështirësi financiare
 - Kërkohej ristrukturimi i detyrimit të mbetur me Banken

- Raportohet nje ngjarje e jashtezakonshme (dentim i kolateralit, humbje e shpallje falimenti, mashtrim etj)
- Ka ndryshim te tregut te pasurive te paluajitshme
- Klienti kerkon financim dhe prona e cila po te si garanci ka pasur vlere te shtuar per arsye te investimeve te realizuara ne te pas momentit te vleresimit te fundit
- Te gjitha shpenzimet do te perballohen nga Kredimarresi.
- g. Te paraqese brenda gjysmes se pare te muajit prill kopjen e vertetuar te bilaneit vjetor qe i dorzohet Zyres se Tatim-Taksave dhe te njoftoje Banken per cdo ndryshim te propozuar nga kjo zyre. Gjithashtu, ne rast se Banka e shikon te arsyeshme, te paraqese analizat financiare 3-mujore ose 6-mujore.
- gj. Te njoftoje me shkrim menjehere Banken per shkaqet qe cenojne seriozisht pagimin ne kohe te Kredise duke propozuar edhe masat konkrete. Me shkaqe te tilla do te kuptojme: cdo fakt juridik qe ndryshon gjendjen financiare te Kredimarrsit, cdo pretendim, padi ose procedure gjyqesore te hapur kunder prones se kredimarrsit dhe te drejtave mbi te.
- h. Te paraqese ndryshimet e bera ne organizimin ligjor te personit Juridik/fizik, ndryshimin e selise apo te perfaqesuesve te tij.
- i. Te mos shperndaje dividente gjate gjithë kohezgjatjes se kesaj kontrate kredie
- j. Te paraqese periodikisht premiumet e sigurimit te objektit te vene si garanci kolaterale dhe sigurimit te jetes se perfaqesuesit te Kredimarrsit.
- k. Te paguaje te gjitha taksat dhe shpenzimet e tjera te lidhura me kredine tani ose ne te ardhmen, shpenzimet e rregjistrimit ne Regjistrin e Barreve Sigurorese apo Agjensine Shtetërore te Kadastres, shpenzimet per vleresimin e pronave apo sendeve te lena si garanci per kredine e marre.
- l. Kredimarresi duhet te ushtroje aktivitetin dhe te respektojë standartet kombetare dhe nderkombetare ne lidhje me ruajtjen e mjedisit dhe ceshetjeve sociale ne perputhje me objektin per te cilin Banka e ka kredituar. Kredimarresi eshte i detyruar te njoftoje menjehere Banken per cdo incident qe mund t'i ndodhe ne lidhje me mjedisin dhe ceshjet sociale, dhe gjithashtu eshte i detyruar te dorzroje ne Banke cdo vit nje raport te leshuar nga autoritetet perkatese te Shtetit Shqiptar ne lushin e mjedisit.
- m. Kredimarresi nuk do te jete i kufizuar te punoje me bankat e tjera qe veprojne ne Republiken e Shqiperise. Ne rast se ne te ardhmen kredimarresi do te kete nevoje per celjen e nje kredie te re, duhet te njoftoje fillimisht Credins Bank, ne te kundert Kredidhenesi/Credins Bank do te aplikojë ndaj Kredimarrsit nje penalitet ne masen 2 (dy) % mbi shumen e mbetur (outstanding) te kredise.
- n. Te paguaje vleren shtese si rezultat i diferencave te krijuara nga luhatjet e kursit te kembinit per kredite ne monedhe te huaj, kur Kredia behet e kerkueshme nga Banka.
- 9.2 Pa pelqimin paraprak dhe me shkrim te Bankes, Kredimarresi per sa kohe nuk ka shlyer detyrimin monetar apo detyrime tjera te kerkuara nga Banka, nuk mund:
- a. Te ndryshoje objektin e vendosur si kolateral per Banken.
- b. Te marre persiper detyrime te tjera monetare ose te marre hua para, ne cfaredo lloj forme ose te garantoje detyrime te nje subjekti te trete.
- c. Te garantoje apo te marre persiper detyrime te nje subjekti te trete.
- d. Te tjetersojë, hipotekojë, te lere peng, barresojë ose te jape si garanci kolaterale, nje subjekti te trete pronen e tij.
- dh. Te kryeje ndryshime ne strukturen organizative apo te biznesit te tij, ne statutin e shoqerise apo dhe ne organet drejtuese te saj;
- e. Te kryeje ndryshime ne pronesine e aksioneve dhe/ose kontributeve te shoqerise;
- f. Te ndryshoje adresen dhe/ose seline e shoqerise;
- g. Te shese apo te jape me qera mjete te rendesishme qe ndikojne ne menyre direkte ne mbarevajtjen e aktivitetit te tij financiar;
- gj. Te bleje plotsisht apo pjeserisht prona te nje subjekti te trete apo te beje rikapitalizimin e mjeteve te tij financiare;
- h. Te likujdohet, shperbehet apo shperndahet, te rreorganizohet ose te bleje plotsisht apo pjeserisht mjetet financiare te nje subjekti te trete ose te beje nje kapitalizim te ri te mjeteve te veta financiare.
- i. Te beje ndonje financim permes transakcioneve te ndryshme direkt apo indirekt per palet dhe/ose personat e lidhur.
- j. Te behet me status te pezulluar ne QKB dhe/ose ne organe tairmore apo me cfaredo statusi qe nuk lejon kryerjen e veprimtarise mbi bazen e te ciles eshte kredituar.

- 9.3.1 Monitorimi i klientit per nje periudhe tre mujore nga momenti i disbursimit deri ne 90 ditet pas realizuar volumi i transaksioneve rritja e normes se interesit me 1%.
- 9.3.2 Administrimi i polices se sigurimit te jetes dhe Inventarit si dhe pagesa e primeve brenda nje muaji nga disbursimi i kredise ne te kundert rritja e normes se interesit me 1%
- 9.3.3 Administrimi i bllokimit te pengjeve ne QKB dhe RBS brenda nje muaji nga momenti i disbursimit te kredise ne te kundert rritja e normes se interesit me 1%

N e n i 10 Sigurimi i Kolateralit dhe i Jetes

10.1 Sigurimi i Kolateralit

- 10.1.1 Banka ka te drejte t'i kerkoje kredimarresit te siguroje, per te gjithë afatin e kredise, pasurine e vendosur kolateral ne favor te Bankes , me shpenzimet e tij, kundrejt rreziqeve Zjarr (dhe rreziqe shtese) dhe Termet dhe ne raste te caktuara edhe rreziqe te tjera (permbytje, rreshqitje, oke, stuhi etj) , ne nje/disa shoqeri sigurimi te pranuar /a nga Banka, duke percaktuar Banken si perfitues ne policon e sigurimit per nje vlere jo me te madhe se shuma e kredise se klientit.
- 10.1.2 Primi i sigurimit te kolateralit do te paguhet ne menyre te menjehershme ne momentin e disbursimit te kredise, per te gjitha vitet per te cilat behet sigurimi. Kredimarresi autorizon Banken qe te mbaje paraprakisht nga shuma e kredituar totalin e primit te polices se sigurimit te kolateralit.
- 10.1.3 Ne rast se Kredimarresi dhe/ose pronari i pasurise ka/kane siguruar me pare kete kolateral per rreziqet per te cilat Banka kerkon sigurimin e tij, atehere Banka ka te drejte te kerkoje shtimin/ndryshimin e perfituesit ne police. Perfituese e pare e nje vlere jo me te madhe se kredia e dhene kredimarresit do te jete Banka. Kredimarresi pranon qe edo kompesim qe rrjedh nga kontratat e sigurimit ti kaloje Bankes brenda vleres se kerkuar per shlyerjen e te gjitha detyrimeve te papaguara nga kredimarresi dhe se ky i fundit nuk do te kete te drejta mbi to.

10.2 Sigurimi i Jetes se Kredimarresit

- 10.2.1 Banka ka te drejte t'i kerkoje kredimarresit ose edo personi tjetër te percaktuar nga Banka te siguroje/sigurojne jeten e tij/tyre per vleren e kredise dhe per te gjithë kolezgjatjen e saj, prane nje shoqerie sigurimi jete te pranuar nga Banka, me shpenzimet e tij/tyre. Perfituese ne policon e sigurimit do te jete Banka ndaj kompensimi eventual nga polica e sigurimit te Jetes per Hua do ti kaloje Bankes per vleren totale te te gjitha detyrimeve te papaguara nga kredimarresi. .
- 10.2.2 Sigurimi i jetës se kredimarresit do te jete me mbulim te plotë (100%) te shumes se siguruar nga aksidentet dhe semundjet.
- 10.2.3 Banka, ne varesi te shumes dhe afatit te kredise aplikon nje prej alternativave te meposhtme per ndryshen e pageses se primit te sigurimit:
- Alternativa 1: Per kredite me vlere deri ne 3.000.000 Leke dhe afat jo me gjate se 7 vite, primi i sigurimit do të llogaritet për te gjithë periudhën e sigurimit, ne përputhje me tabelën e amortizimit te kredisë dhe do te paguhet menjëherë në momentin e disbursimit të kredisë në një kësht të vetëm për të gjithë periudhën e sigurimit. Kredimarresi autorizon Banken qe te mbaje paraprakisht nga shuma e kredituar totalin e primit te polices se sigurimit te jetes.
 - Alternativa 2: Per kredite me vlere mbi 3.000.000 Leke dhe/ose me afat me te gjate se 7 vite, primi i sigurimit do të llogaritet për te gjithë periudhën e sigurimit, ne përputhje me tabelën e amortizimit te kredisë dhe do te paguhet me keste vjetore sipas nje plani pagese te integruar ne policon e sigurimit te jetes. Kredimarresi autorizon Banken qe te mbaje paraprakisht nga shuma e kredituar ne llogarine e tij primin e sigurimit per vitin e pare dhe ne vijim te debitoje llogarine e klientit per keshtet vijuese te primeve ne datat e polices se sigurimit te jetes. Klienti gjithashtu, autorizon Banken te debitoje ne edo kohe, edo llogari tjetër te tij nese gjendja kreditore ne llogarine e lidhur me kredine nuk eshte e njalfueshme per pagesen e keshtit vijues te primit, sipas polices se sigurimit te jetes. Në rast se llogaria/llogarite e klientit nuk ka/kane gjendje kreditore në datën/datat e pagesës së primit të sigurimit sipas planit në policon e sigurimit, klienti autorizon Bankën të bllokojë llogarinë e lidhur me kredine për vlerën e primit të sigurimit . Llogaria do të qendrtojë e bllokuar deri sa të kreditohet vlere e plotë e primit të sigurimit dhe të realizohet ekzekutimi i kësaj pagese".

- 10.3 Ne rastin kur kredimarrësi nuk paguan primin e sigurimit sipas afatit dhe drejta që në mënyrë alternative të kërkojë ose zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e pasurisë së kredise në total së bashku me penalitetet, interesat e akumuluar deri në momentin e kërimit nga Banka, ose të aplikojë një penalitet në masën 2% mbi shumën fillestare të kredise.
- 10.4 Në rast se kredimarrësi dhe shoqëria siguruese janë në konflikt gjyqësor për probleme kompensimi, të gjitha shpenzimet do të perballohen nga Kredimarrësi.

Neni 11

Perfundimi i kontratës

- 11.1 Kontrata e Kredise përfundon me shlyerjen përfundimtare të të gjitha detyrimeve të kredimarrësit ndaj Bankes.

Neni 12

Rastet e mospërbushjes dhe të kthimit të plate të kredise

- 12.1 Në rastet e verifikimit të ndonjerit nga kushtet e mëposhtme por pa u kufizuar vetëm në këto, Banka ka të drejtë të ndërmarre të gjitha veprimet ligjore që ajo i gjykon të arsyeshme dhe/ose të kërkojë rikthimin e kredise dhe interesave të akumuluar:
- a. Kredimarrësi nuk paguan 3 (tre) kështu të njëpasnjëshme brenda afatëve të parashikuara në këtë kontratë.
 - b. Kur Kredimarrësi nuk ka respektuar dhe/ose ka shkelur parashikimet sipas nenit 9 të kësaj kontrate;
 - c. Faktet juridike, vertetimet, deklaratat, pohimet, miratimet dhe çdo dokument tjetër i dorëzuar nga kredimarrësi nuk është i vertetë ose nuk është bërë në mënyrë dhe në kohën e parashikuar në këtë akt kontrate kredie dhe në ligj.
